

INNOVATION CHALLENGE FUND

THIRRJA E 4-ËRT



Çfarë është **INOVACION** në kontekstin e **Challenge Fund**?

- Një zgjidhje e cila i shton vlerë biznesit tuaj
- E bën atë më eficient
- Zvogëlon kostot
- Mund të jetë një zgjidhje e re e cila ka të bëjë me një proces, një produkt ose shërbim
- I jep zgjidhje një sfide që hasni në përditshmëri në biznesin tuaj
- Një zgjidhje e cila funksionon mirë në kontekstin lokal ku operon biznesi juaj

Çfarë kërkojmë nga ju?

- Një propozim NOVATIV
- Një propozim të REALIZUESHËM dhe të QËNDRUESHËM
- Një propozim i cili ka IMPAKT SOCIAL



Fusha të cilat do të vlerësohen me prioritet për kategorinë e **startups**

- Bujqësi
- Produkte dhe/ose shërbime dixhitale
- Zgjidhje novatore të cilat lehtësojnë sfidat e lidhura me pandeminë Covid-19

Fusha të cilat do të vlerësohen me prioritet për kategorinë e **Innovation Supporting Organizations (ISOs)**

- Programe të cilat mbështesin gratë sipërmarrëse
- Programe të cilat mundësojnë lidhje dhe akses me aktorë të sektorit privat dhe/ose investitorë potencial
- Programe të cilat ofrojnë ura bashkëpunimi dhe akses në programe rajonale dhe/ose ndërkombëtare të cilat fuqizojnë eko-sistemin e sipërmarrjes në Ballkan
- Programe të cilat mbështesin ekonominë e gjelbër dhe të qëndrueshme (circular economy)
- Programe të cilat mbështesin produktet dhe shërbimet dixhitale



Si të aplikosh?

Apliko online:

<http://challengefund.euforinnovation.al/index.php/apply/>

Jepi kohën e nevojshme aplikimit!

Merrni parasysh kohën dhe përgatitjen e nevojshme për të dorëzuar aplikimin. Informacioni që do t'ju kërkohej gjatë aplikimit, do të kërkojë një analizë të qënësishme të biznesit tuaj, ndaj do ju sugjerojmë të shikoni me kujdes dokumentat udhëzues si dhe të shkarkoni formularët e aplikimit offline, përpara se të plotësoni aplikimin online. Në momentin kur do plotësoni formularin online, nuk mundet ta ruani dhe të vazhdoni punën më pas. Kur ju shtypni butonin SEND, aplikimi juaj konsiderohet i përfunduar.

Çfarë ofrojmë ne?

- Jo vetëm fonde
- Mentorim të vazhdueshëm (financiar, ligjor dhe teknik sipas nevojave të biznesit tuaj), përgjatë periudhës së zbatimit të projektit
- Transparencë – duke filluar që nga procesi i aplikimit, tek vlerësimi, dhe përgjigjia e pyetjeve tuaja - të gjitha këto hallka do të bëhen online
- Vlerësimi do të kryhet në 5 nivele – 1) Skuadra e menaxhimit të Challenge Fund, 2) Skuadra financiare, 3) komiteti i vlerësimit Suedez, 4) Bootcamp-i dhe 5) Skuadra ligjore

Kush mund të aplikojë në Challenge Fund?

- Për start-up të regjistruara midis 0-5 vjeç
- Organizata të cilat mbështesin inovacionin (inkubatorë, akseleratorë, Universitete, NGO, kompani private, dhe të gjithë ato organizata të cilat mbështesin start-up-et)

Sa fonde mund të merren?

DERI NË

30,000 €

STARTUPS
MIDIS 0-5 VJEÇ

DERI NË

100,000 €

ORGANIZATA TË CILAT
MBËSHTESIN INNOVACIONIN
DHE START-UP JO MË TË REJA SE 1 VJEÇ

DATA TË RËNDËSISHME

15 SHKURT 2021 - 15 MARS 2021

15 MARS 2021 - QERSHOR 2021

**APLIKIMET E THIRRJES
SË 4-ËRT JANË TË HAPURA**

VLERËSIMI I THIRRJES SË KATËRT

KENI PYETJE?

Na shkruani në:
challengefund@euforinnovation.al

Keni nevojë për asistencë se si të plotësoni formularin e aplikimit?
Prenotoni një konsultim individual në këtë link:

<https://euforinnovation.al/one-to-one-consultations-for-challenge-fund-application/>



Kushtet për të fituar fondin

- Biznesi duhet të jetë i regjistruar në Shqipëri (diaspora dhe shtetas jo shqipëtar mund të aplikojnë për këtë fond, përderisa biznesi është i regjistruar dhe operon në Shqipëri)
- Një biznes i cili nuk kyen aktivitete të regjistruara për më shumë se 36 muaj nga data e publikimit të thirrjes nuk mund të përfitojë nga fondi i Challenge Fund
- Aplikuesit duhet të marrin përsipër të kontribuojnë me minimalisht **50%** të kostos së financimit (të vlerës totale të projektit të cilët ata propozojnë)
- Individët / skuadrat të cilat aplikojnë, kanë përgjegjësi të plotë për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përfshira në aplikim
- Periudha për zbatimin e fondit do të jetë deri më 6 muaj



The Challenge Fund is part of the EU for Innovation project, funded by the European Union and implemented by GIZ and the Embassy of Sweden. The project aims to strengthen the eco-system for innovation and start-up promotion in Albania.

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Suedi
Sverige